



SS

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI KONTRAKTOR**  
**BASHKIA BULQIZE**

Adresa : Lagjia Minatori Bulqize, Albania

email.bashkia.bulqize@bulqize.gov.al

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Bulqizë më 13.07.2021

Drejtuar: Operatorit ekonomik "EGLAND" me Adrese: Diber Shupenze ZOGJAJ Fshati Zogaj.Zyra tek ndertesa pranë fabrikës së mermerit/Zogaj. me NIPT: J96829419D.

Procedura e prokurimit/lotit: Mirmbajtje e Kanaleve ujitëse.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-96665-05-27-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: /Mirmbajtje rrugësh rurale,Kohezgjatja e kontrates: 1 Muaj nga momenti i neshkrimit te kontates.

Publikimet e mëparshme:nuk ka:

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 83 datë 31 Maj 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. EGLAND Me Nipt: J96829419D

Vlera: 6 582 200 (gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa TVSH

2.SHEHU

ME NIPT: J66702707S

Vlera: 6 509 900 (gjashtë milion e pesëqind e nëntë mijë e nëntëqind) lekë PA TVSH.

3.BOE: K.M.K & Caushi M

K.M.K: Me NIPT:L78223801E

Caushi M: Me NIPT:L88419801O

Vlera: 6 466 940(Gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë më TVSH.

4. 2N me NIPT: L31615017L

Vlera: 5 990 734 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë Pa TVSH

**Nga pjesëmarrësit janë kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. ENGLAND Me Nipt: J96829419D

Vlera: 6 582 200 (gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa TVSH

**Nga pjesëmarrësit janë Skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1.SHEHU

ME NIPT: J66702707S

Vlera: 6 509 900 (gjashtë milion e pesëqind e nëntë mijë e nëntëqind) lekë PA TVSH.

2.BOE: K.M.K & Caushi M

K.M.K Me NIPT:L78223801E

Caushi M Me NIPT:L88419801O

Vlera: 6 466 940(Gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë më TVSH.

3. 2N me NIPT: L31615017L

Vlera: 5 990 734 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë Pa TVSH.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**SHEHU:**

Në dokumentet standarte të tenderit në Pikën 2.2 Autoriteti Kontraktor ka vendosur kriterin e mëposhtëm:

Kopje të vërtetuar të bilancit të vitit ushtrimor 2018, 2019, 2020 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave dhe raportin e auditimit sipas kerkesave te ligjit Nr.10091 date 05.03.2009.

Nga verifikimi i bilanceve te paraqitur nga operatori ekonomik SHEHU rezulton se totali I aktiveve për periudhen kontabël 2019 dhe 2020 tejkalon vlerën prej 50 milionë lekësh në të dyja vitet.

Me anë të vertetimin Nr. T04327615 date 01.07.2021 rezulton se numri mesatar i punonjësve të siguruar për periudhën kontabël të vitit 2019 dhe 2020 është 30 persona.

Në Zbatim të ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009. Për Auditimin Ligjor, Organizimin E Profesionit Të Audituesit Ligjor Dhe Të Kontabilistit Të Miratuar, Operatori Ekonomik SHEHU ka pasur detyrimin të paraqesë Raport auditimi Ligjor I Pasqyrave Financiare.

Sa më sipër ky kriter nuk plotësohet.

Në Kriteret e veçanta të kualifikimit është vendosur kriteri:

.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Puna të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet leke pa T.V.SH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit;

ose

b. Kontrata të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marre së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën e kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Deklaratë sipas shtojcës nr 8 shoqëruar me :

- Kontrata
- Situacioni përfundimtar
- Aktin e kolaudimit
- Aktin e marrjes në dorëzim.
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit /ose certifikatë e marrjes në dorëzim e përkohshëm.

Në rastin e përvojes së mëparshme në sektorin privat kërkohen të paraqiten:

- Kontrata
- Aktin e kolaudimit Situacionin përfundimtar.
- Fature tatimore ose cdo dokument tjetër që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që verteton përbushjen e suksesshme të punëve
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit /ose certifikatë e marrjes në dorëzim e përkohshëm.

Operatori ekonomik SHEHU ka paraqitur Kontratën Nr.1623.prot date 27.06.2018 me objekt:” Shërbime në rrugët e Bashkisë”

Kontrata e Paraqitur nga operatori ekonomik nuk është punë e ngjashme pasi objekti i prokurimit është “Mirëmbajtje Kanale vaditëse” ,që ka të bëjë me vepra kullimi e vaditje. produkti i përfituar nga realizimi i shërbimit nga Operatori ekonomik SHEHU në Bashkinë Klos është mirëmbajtje rrugësh dhe nuk është i ngjashëm me objektin që prokurohet.

Operatori ekonomik SHEHU Ka paraqitur Kontratën Nr.687 date 15.05.2019, Me objekt: “Rikonstruksion i zyrave të nënprefektures Mat” Kjo Kontratë e paraqitur nga Operatori ekonomik SHEHU, kjo punë e realizuar nga operatori ekonomik ka të bëjë me: Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, Pra ka të bëjë Ndërtime civile në objekte, Produkti i përfituar nga realizimi i punës nuk është i ngjashëm me objektin që prokurohet.

Sa më sipër kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik nuk merret në konsideratë.

Operatori ekonomik ka paraqitur Kontratën me Nr.80/20 date 23.01.2018 me Objekt: “Rikonstruksion dhe hidroizim i tarracës së tregut të mishit të Bashkisë Dibër”

Kjo punë e realizuar nga operatori ekonomik ka të beje me: Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, Pra ka të bëjë Ndërtime civile në objekte, Produkti I përfituar nga realizimi I punës nuk është I ngjashëm me objektin që prokurohet.

Sa më sipër kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik nuk merret në konsideratë.

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratën me Nr.45/10 date 04.09.2017 me Objekt: Rikonstruksion I varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018, Perveç faktit qe puna e realizuar nuk është punë e ngjashme pasi nuk ka të beje me vepra kullimi, vaditje dhe produkti i perfituar nga realizimi i kësaj pune nuk është I ngjashem me objektin qe prokurohet, kjo kontratë nga verifikimi I formularit te vleresimit të paraqitur nga operatori ekonomik SHEHU rezulton se ka përfunduar në datën 22.12.2017, Kontrata nuk është realizuar gjatë tre viteve të fundit, sic kerkohej në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik nuk merret në konsideratë.

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratën me Nr.51/19 date 27.12.2019 me Objekt: “Mirmbajtje dimërore në rrugët Rurale, Bashkia Diber” Ky sherbim I realizuar nga Operatori ekonomik nuk merret parasysh nga Autoriteti Kontraktor pasi nuk është I ngjashëm me objektin qe prokurohet: Kontrata e mesiperme e paraqitur nga Operatori ekonomik SHEHU ka të bëjë me pastrimin e Borës dhe Hedhjen e kripës në rrugë, Kjo kontratë nuk është punë në ndërtim, në referim të neni 3 te ligjit Nr.8402, DATE 10.9.1998 Per Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit, I ndryshuar, I cili citon; nëse nuk përcaktohet ndryshe punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera, Kontrata dhe preventivi I paraqitur nga Operatori ekonomik nuk ka asnjë element ndërtimi të perfshirë.

Sa më sipër kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik nuk merret në konsideratë.

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratë me Nr.16/13 date 23.10.2018 me Objekt:Rehabilitimi I sistemit vaditës Begjunec-Dobrove, Bashkia Dibër.

Vlera e Kontraktuar e ketij Objekti sipas kontrates është:2 433 206( dy milion e katerqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtë) lekë Me TVSH, Vlera pa TVSH është: 2 027 671,66 (dy milion e njezet e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë PA TVSH. Duke u nisur nga kriteri I vendosur ku kerkohet që: operatori ekonomik duhet te paraqese, dokumentacion per Pune te ngjashme per nje objekt te vetem me vlere jo me te vogel se 50 % e vleres se perllogaritur te kontrates qe prokurohet leke pa T.V.SH, te realizuar gjate tre viteve te fundit, Kontrata e paraqitur nga Operatori ekonomik SHEHU nuk arrin 50% të vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

Sa më sipër Operatori ekonomik nuk ploteson kriterin për punë të ngjashmë.

## 2. BOE: K.M.K & Caushi M

Bashkimi I operatorëve ekonomik K.M.K& Caushi M, në formularin e ofertës dhe në preventivin e ofertës nuk kanë ndarë zërat e punimeve të marra përsiper, si rrjedhoje Autoriteti kontraktor e ka të pamundur, verifikimin për disponimin e kapaciteteve teknike profesionale që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Operatori ekonomik ka paraqitur si punë të ngjashme kontratën Nr. 16/10 date 05.07.2021 me Bashkinë Dibër. nga verifikimi I formularit të vlerësimit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik K.M.K ka realizuar 42% të punimeve. vlera totale e objektit të paraqitur si punë e ngjashme është: 6 282 407 (gjashtë milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatë) lekë pa TVSH. vlera e realizuar nga operatori ekonomik sipas përqindjes është: 2 638 610,94(dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dhjetë presje nëntëdhjetë e katër) lekë PA TVSH.

Sipas Akt marrëveshjes të paraqitur nga operatori ekonomik K.M.K&Caushi M rezulton se perfaqesuesi në këtë akt marrëveshje është operatori ekonomik K.M.K. Referuar nenit 88 pika 3 te VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit Publik” I cili citon: Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të

këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në referim të nenit 39 pika 5 germa “a” rezulton se Operatori ekonomik nuk arrin vlerën prej 50% e fondit limit të objektit që prokurohet.

Operatori ekonomik Caushi M ka paraqitur si punë të ngjashme Kontratën me Nr.462/2 date: 07.02.2019 me Objekt: Rikonstruksion I Rrugës Golem- Mali I Robit

Kontrata e Paraqitur nga operatori ekonomik nuk është punë e ngjashme pasi objekti I prokurimit është “Mirmbajtje Kanale vaditëse” ,që ka të bëjë me vepra kullimi e vaditje. produkti I përfituar nga realizimi i shërbimit nga Operatori ekonomik Caushi M në Bashkinë Kavajë është Punime Në rrugë dhe nuk është I ngjashëm me objektin që prokurohet.

Operatori ekonomik Caushi M nuk ka paraqitur Bilancin e vitit 2020.

2N

Mjeti me targë AA463HR është paraqitur nga OE ekonomik Si kamion, nga verifikimi dokumentacionit rezulton se mjeti është kamionçinë deri në 3.5 ton. Sa më sipër mjeti nuk është sipas kërkesave të vendosura nga AK.

Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion për mjetin me targa AB697BJ të marre me qera me Nr.Rep 4132 Nr.Kol.1545 datë.08.06.2021.Në shtojcën për disponimin e mjeteve OE ekonomik ka deklaruar se mjetin kokë kamioni si dhe nga verifikimi I dokumentacionit rezulton se mjeti ka kapacitet mbajtës 7.5 deri në 18 ton. Mjeti nuk është sipas kërkesave të vendosura nga AK.

Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion për mjetin me targë ADR 524 të marrë me qera me Nr.Ref.4132 Kol 1545 datë 08.06.2021.Nga verifikimi I dokumentacionit rezulton se çertifikata e kontrollit teknik ka skaduar në 02.03.2021. Referuar udhëzimit Nr.36 datë 23.12.2020. “Për zgjatjen e afatit të vlefshmerisë së çertifikates së kontrollit teknik”. Çertifikata është e vlefshme deri në 02.06.2021.Mbështetur në urdhërin Nr.237 date 31.03.2021 të DPSHTR. Të gjitha mjetet të pajisen me lejen e qarkullimit ose çertifikatën e kontrollit teknik me vule me afat vlefshmerie 30 ditë nga mbarimi I afatit të parashikuar në aktin normativ nr 36.date 23.12.2020. Nga verifikimi dokumentacionit rezulton se leja e qarkullimit dhe çertifikata e kontrollit teknik nuk janë të pajisura me vule me afat 30 ditor nga Drejtoria Rajonale të shërbimeve të transportit rrugor.

Sa më sipër Operatori ekonomik nuk ka në dispozicion numrin e mjeteve të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në formularin e sigurimit të ofertës transferta e sigurimit të ofertës është në llogarinë e Bashkise Bulqize dhe jo në Drejtorinë Përgjithshme të Transportit rrugor Tiranë, siç është specifikuar në formularin e sigurimit të ofertës.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë EGLAND me Adrese: Diber Shupenze ZOGJAJ Fshati Zogaj.Zyra tek ndertesa pranë fabrikës së mermerit/Zogaj, se oferta e paraqitur me vlerë totale: 6 582 200 (gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”

**ZYRTARI I AUTORIZUAR**  
**ENKELEDA LLESHI**